

## **Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike**

1. Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.
2. Krijimi dhe rregullat e administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

### **PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK**

– Palët e interesuara

1. Palët e interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë: a) organet publike; b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. Personat e tjerë të huaj mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

– Të drejtat e palëve të interesuara

Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

- a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;
- b) t’u propozojnë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projekteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga organi publik, në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji;
- c) t’u dorëzojnë organeve publike komente dhe rekomandime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.

## RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

– Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve

1. Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrimit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

- a) me postë elektronike;
- b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;
- c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
- d) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.

2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

3. Adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin:

– Njoftimet paraprake

1. Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.

2. Në fazat fillestare, organi publik, kur e gjykon të nevojshme, publikon në një nga format e parashikuara në nenin 11 një njoftim paraprak për aktin që do të hartojë për të siguruar informacione nga palët e interesuara.

3. Çdo palë e interesuar mund t'i përgjigjet njoftimit paraprak brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, duke dorëzuar komente dhe rekomandime.

– Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:

- a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
- b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;

- c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
- d) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

2. Aksesin në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.